



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0267

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi Brajshori Kryetare, Batisha Ibrahim Anetare dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) “Noi Construction” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Komuna e Lipjanit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan” me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1, me 16/06/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Noi Construction” SH.P.K. me nr. 2025/0267, e datës 12/04/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan” me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1.
2. Vertetohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të Komuna e Lipjanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan” me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik “Noi Construction” SH.P.K.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna e Lipjanit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 19.02.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme të QKMF – Lipjan” me numër të prokurimit 613-25-851-5-2-1.

AK me datën 28.03.2025 ka publikuar Njoftimi mbi vendimin e për dhënie të kontratës OE “Begisholli Company”.

Me datën 02.04.2025, OE “Noi Construction” SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. AK me datën 04.04.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 12.04.2025 operatori “Noi Construction” SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0267 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 24.04.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “Noi Construction” SH.P.K

Përgjigje për pretendimin tuaj te parë: Kërkesë e AK pika a) ka qene Min Një inxhinier i ndërtimtarisë sistemi 5 vjeçar ose (master) drejtimi konstruktiv min 5 vite përvojë pune pas diplomimit, Gjate kontrollimit te dokumentacionit tuaj ju keni vendosur dokumentacion për inxhinierin tuaj por tek diploma e tij është vërejtur qe Diploma është mbrojtur me date 9 Mars 2022 dhe kjo nuk është 5 vite përvojë pune pas Diplomimit siç është kërkuar nga AK. Ky pretendim i juaji është i pa bazuar.

Përgjigje për pretendimin tuaj te dytë: Tek Dëshmia 2 është kërkuar: Për te gjithë stafin kërkohen Kontratat e punës, ose para kontratat e punës me validitet dhe kohëzgjatje te këtij projekti. E drejte e AK është te paraqes kërkesën për një dokument te caktuar dhe ne këtë rast secili

punëdhënës duhet të dije që një kontratë e punës element baze ka kohën e fillim/mbarimit, pagën dhe elemente tjera që përcakton ligji i punës e jo AK. Tek dokumentacioni juaj është vërejtur që nuk i keni të gjitha kontratat e punës për stafin tuaj poashtu edhe të ato kontrata dhe para kontrata që keni bashkangjitur janë të mangëta në baze të ligjit të punës ju mungojnë fillim/mbarimi dhe paga baze duke u bazuar në ligjin Nr. 03/L-212, të nenit 10 dhe 11 po të këtij ligji.

Sqarim: Në dokumentacionin tuaj kemi hasur në një dokument ekskavator me zi ngjir tipi: 735 II LS dhe në këtë dëdë është edhe një faqe shtese që ka një përbërje shtese të mjeteve të punës: Luge për pastrim të lumenjve, luge për gërmim 2 copa, qekan hidraulik, kran hidraulik dhe gërrshërë për demolim, pasi që ju skeni pasur një dokument të veçantë për këtë kërkesë sipas pikës 1). Poashtu në kemi shikuar lidhur me këtë ekskavator se çfarë specifikimi mund të ketë dhe gjatë evidentimit duke u bazuar në të dhënat sipas dudit ekskavator Furukaëa tipi 735 II LS përket 18.9T, por në këtë dëdë janë edhe disa pajisje tjera shtese që kanë peshe/tonazh të lartë. Ekskavatori në dud doganor me të gjitha këto paisje janë 24,500 kg apo 24.5T, ekskavatori në baze të specifikimit sipas këtij tipi dhe nr është 18,900 kg apo 18.9 T, duke u bazuar në kg e mbetura janë dhe 5600 kg apo 5.6T, që nëse ndahen për secilën pajisje është 933 kg për secilën dhe ky DUD doganor nuk ka dokumente shtese dhe si dëshmi e dorëzuar nga ana juaj nuk plotëson kërkesën e AK-se dhe ju njoftojmë që AK nuk mund të marr për baze një dokument të tillë sepse është jashtë kërkesës së AK-se. Poashtu nuk është mundur të kërkohej sqarim shtese sepse ju keni ofruar dëshmi e cila nuk është plotësuar. Ky pretendim i juaji është i pa bazuar.

Përgjigje për pretendimin tuaj të katërt: Tek kërkesa 3, pika h) Eskavator max 1 T, ju keni dorëzuar një dud doganor i cili nuk ka përmbajtje se kujna i përket ky dokument dhe nuk mund të mirret për baze një dokument i tillë, pa të dhënat e pronarit dhe sikur ju nuk do të kishit vendosur asnjë dokument për këtë paisje në si AK do ju kërkonim sqarime shtese, por ju keni ofruar dëshmi të cilat nuk përmbushin kërkesën dhe dëshmitë e kërkuara nga AK. Ky pretendim i juaji është i pa bazuar. Në rast se ju si OE do i përkisni këto dokumente që nuk i keni vendosur në ofertën gjatë aplikimit ju do të ngarkonit në këtë kërkesë për rishqyrtim por këto janë dëshmi që nuk mund të plotësohen dhe për të njëjtat nuk mund të kërkohej sqarim shtese. AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Noi Construction" SH.P.K në ankesën Nr. 0267/2025 janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë i OE ankues: Lidhur me arsyen e parë të eliminimit, ku autoritet kontraktues e ka eliminuar se inxhinieri i ndërtimtarisë – konstruktive, i prezantuar në oferte nuk e plotëson përvojën e punës (5 vjeçare), me arsyetimin se ka diplomuar në vitin 2022 dhe nuk e arrin përvojën 5 vjeçare, ekspert i shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues të kërkesa nr. 2 e dosjes së tenderit ka kërkuar: Kërkesa 2: Një inxhinier i ndërtimtarisë sistemi 5 vjeçar ose (master) drejtimi konstruktiv, min. 5 vite përvojë pune pas diplomimit, të caktohet menaxher i projektit.

Pretendimi i dytë i OE ankues: Pretendimi ka të bëjë me arsyen e dytë të eliminimit ku autoritet kontraktues pretendon se kontratat e prezantuara të punëtorëve, nuk janë në përputhje me ligjin e punës.

Pretendimi i tretë i OE ankues: Lidhur me arsyen e tretë të eliminimit, ku autoriteti kontraktues ka konstatuar se: të kërkesa nr. 3, është kërkuar pika 1) gërrshërë për demolim betoni dhe prerëse e cila montohet në ekskavator min 5 T –(min 1 cop), juve keni dorëzuar një dokument Dud doganor për një ekskavator dhe të dhënat për ekskavator dhe në të jen të paraqitura edhe një letër shtese me sista pajisje në ato pajisje figuron edhe do gërrshërë për demolim betoni por nuk

plotësohet kërkesa e AK si është kërkuar ne NJK dhe DT sepse kërkesë e AK ka qene” gërshtë për demolim betoni dhe preserë e cila montohet ne ekskavator min 5 T, dëshmia e dorëzuar është jashtë kërkesës se AK.

Pretendimi i katërt i OE ankues: Lidhur me arsyen e katërt te eliminimit, ku AK e eliminon me arsyetimin se të dhënat/dëshmitë e pronësisë ne Dud-in doganor, pra sipas AK nuk ka te dhëna lidhur me pronarin e pajisjes.

Pretendimi i pestë i OE ankues:OE ankues, ne ankesën e tij pretendon se i rekomanduari për kontratë, ka dorëzuar dëshminë pajisjes gërshtë për demolim betoni dhe prerëse e cila montohet ne eskavator te një kompanie tjetër, sepse sipas OE ankues, OE i rekomanduar për kontratë Begisholli Company ka nr unik: 810134627, ndërsa dud-i doganor i dorëzuar ne oferte i përket N.T.P Begisholli me nr unik: 810638463.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0267/2025, i cili është dorëzuar me datë 24.04.2025.

Lidhur me pretendimet e OE “Noi Construction” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0267 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje në pretendimin e pare ankimor: Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe shqyrtimit te te gjitha provave sqaron se OE ankues ne ofertën e tij ka prezantuar pjesë te stafit (H. K) Inxhinier i ndërtimtarisë – drejtimi konstruktiv, i njëjti inxhinier me vendim është caktuar edhe menaxher i projektit. Eksperti shqyrtues sqaron se arsye e eliminimit nga autoriteti kontraktues nuk qëndron sepse Inxhinieri i ndërtimtarisë-konstruktiv, e plotëson kërkesën e dosjes se tenderit dhe njeherit sqaron se për te njëjtin janë prezantuar diplomën e cila dëshmon përfundimin e studimeve me datën 27/10/2006, dhe referuar CV-se, listës se projekteve si dhe referenca te mjaftueshme te cilat dëshmojnë përvojën profesionale pas diplomimit. Andaj eksperti shqyrtues sqaron se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e dytë: eksperti shqyrtues, vlerëson se nuk qëndron ky arsyetim i AK-se, për arsye se mbi bazën e dëshmimeve te dorëzuar AK, mundet qe konform dispozitave ligjore të nenit 72 të LPP-se të kërkojë sqarime shtese lidhur me dëshmitë e prezantuara dhe njeherit sqaroj se nuk mund ta eliminoje për një kërkesë e cila nuk është vendosur ne dosje te tenderit dhe ne njoftimin për kontratë. Konkretisht autoriteti kontraktues, i ka kërkuar gjithsej 13 staf/punëtorë për realizimin e këtij projekti ndërsa OE ankues i ka prezantuar gjithsej 13. Andaj, siç u sqarua edhe me larte mbi bazën e listës se stafit dhe eventualisht ndonjë dyshimi tjetër AK, mund te kërkojë sqarime shtese lidhur me kontrata e punëtorëve te prezantuar ne listën e stafit-punëtorëve.

Përgjigje në pretendimin e trete ankimor: Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues, ne ankesën e tij e pranon se nuk e ka ngarkuar marrëveshjen me te cilën e ka marr me qera nga OE Dani EDR

Sh.p.k, pajisjen gërrshërë për demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator.

Lidhur me këtë pretendim ekspertit shqyrtues, sqaron se OE ankues ne ofertën e tij, konkretisht ne listën e pajisjeve, ne piken nr: 13 te listës se pajisjeve e ka prezantuar pajisjes ne fjale, ndërsa s ai përket mungesës se dëshmive për këtë pajisje, autoriteti kontraktues është dashur qe konform dispozitave të nenit 59 dhe 72 të LPP-se të kërkojë sqarime shtese.

Përgjigje në pretendimin e katërt ankimor:Eksperti shqyrtues, sqaron se lidhje me pajisjen eskavatore max. 1t, përveç Dud-it doganor, OE ankues e ka dorëzuar edhe faturën e blerjes me te cilën dëshmohet pronësia, megjithatë AK, ka mundur te kërkojë sqarim shtese për dyshimet eventuale qe ka pasur.

Përgjigje në pretendimin e pestë ankimor: Eksperti shqyrtues, lidhur me këtë pretendim sqaron se nuk qëndron për arsye se i rekomanduari për kontrate Begisholli Company ka nr unik: 810134627 e ka dorëzuar edhe marrëveshjen për shfrytëzimin e pajisjes me OE N.T.P Begisholli me nr unik: 810638463. Ndërsa sa i përket pretendimit te OE ankues dhe dyshimit të tij se Dud-i doganor është manipuluar sepse sipas te dhënave rezultojnë tjera specifika te pajisjes, ekspertit shqyrtues, i rekomandon Autoritetit Kontraktues qe gjate rivlerësimit ta verifikojë dëshminë ne fjale.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues nuk është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaq operatori ekonomik është pajtuar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këto dy lëndë mund të konfirmohen vetëm pjesërisht përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të mbështetura edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht raporteve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli Shqyrtues e mbështete pjesërisht raportin e ekspertit për shkak se nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore konform nenit 113 dhe 114 të LPP. Sa i përket pretendimeve ankimore nr.1 dhe 2 e mbështete arsyetimin e ekspertit shqyrtues. Ndërsa, sa i përket përgjigjeve në pretendime ankimore të radhitura sikurse në ekspertizë me nr. rendor 3 dhe 4 nuk e mbështet konstatimin e ekspertit shqyrtues, i cili nuk i vlerëson pretendimet ankimore në bazë të dispozitave ligjore. Lidhur me pajisjen gërrshërë për demolim betoni dhe prerese e cila montohet ne eskavator min 5 T, edhe ankuesi edhe eksperti e pranojnë që marrëveshja nuk është e ngarkuar as në ofertë dhe as në ankesë në OSHP, andaj, neni 72 i LPP nuk ka karakter detyrues për AK që të kërkojë sqarime shtesë, po ashtu as ankuesi me ankesë në OSHP nuk e ka dëshmu se e posedon këtë marrëveshje dhe është fakt se këtë nuk ka mundur ta bëjë për shkak se e njëjta as me sqarime nuk mund të

kërkhet pasi që nuk mund të vërtetohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar para ofertimit ashtu sikurse kërkohen me Ligj. sikurse edhe për me pajisjen eskavatore max. 1t.

Lidhur me pretendimin se i rekomandauri për kontrate, ka dorëzuar dëshminë e pajisjes gërsherë për demolim betoni dhe prerëse e cila montohet në eskavator të një kompanie tjetër, sepse sipas OE ankues, OE i rekomanduar për kontrate Begisholli Company ka nr unik: 810134627, ndersa dud-i doganor i dorezuar ne oferte i perket N.T.P Begisholli me nr unik: 810638463. Nuk i plotëson kushtet që të shqyrtohet nga ana e PSH sepse e njëjta nuk është paraqit në kërkesë për ri-shqyrtim, konform nenit 64.2 të RRegullores për Prokurim Publik dhe nenit 109 të LPP. Megjithate, PSH obligon AK para nënshkrimit të kontratës të bëjë një kontroll efektiv konform nenit 52.7 të LPP.

Paneli shqyrtues thekson faktin se Autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

-Përfundim-

Bazuar në kompetencat e OSHP-së të parapara me nenin 105, lidhur me nenin 106 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vuri në të tjerat e tjera dhe nenin 103 të Ligjit të cituar sipas të gjitha palëve të interesuara do të kenë të drejtë të barabartë në procedurat e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se, asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet që të diskriminoj ose dëmtoj një person tjetër në proces ose të një personi ose ndërmarrje.

OSHP niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon njohurinë e plotë në ushtrimet e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitetin e buxhetit. Prandaj nisur nga të lartcekurat dhe duke i administruar me kujdes të gjitha provat e bashkëngjitura në shkresat e kësaj lënde, Paneli Shqyrtues ka qëndruar si në dispozitiv të vendimit të marrë, i bindur se ka aplikuar zgjidhjen e duhur konform ndikimit në dhe natyrës së çështjes në rastin konkret duke e konsideruar po ashtu të drejtë dhe të arsyeshme edhe lejimin e mjeteve të deponuara në emër të tarifave ankimore për OE ankues.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**
- **OE - NOI CONSTRUCTION SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: